Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 11.09.2017 vit.god.
Nr. i organit Org.broj | Numri broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost
02-035/02-843

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr o3/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008, nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 2 të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vitisë nr 01-016/775 të datës 28.07.2017 për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të klubeve futbollistike që garojnë në Superligë dhe Ligën e parë, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 15.000,00€ KLUBIT TË FUTBOLLIT "VLLAZNIA " NGA POZHERANI

**I.**

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **15.000,00€** me shkronja ( pesëmbëdhjetë mijë euro), Klubit të Futbollit " Vllaznia" nga Pozherani në emër të mbështetjes financiare të këtij klubi për zhvillimin e garave në Superligë të Republikës së Kosovës.

**II.**

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 Fondi Burimor 21, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, programi buxhetor Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Obligohet drejtori i KF "Vllaznia " nga Pozherani që të paraqet raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të KF "Vllaznia " nga Pozherani.

**III.**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

**IV.**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Viti, më 11.09.2017
Vendimi u dorëzohet:

1. KF "Vllaznia " Pozherani
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi